



**Kolegji AAB**

CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

Programi: Administratë publike dhe Diplomaci  
Studimet Master

Punim masteri

**Roli i stileve të lidershipit në menaxhimin e administratës  
publike: Rast studimi komuna e Gjilanit**

Kandidatja:  
Krenare Lutfiu

Mentori:  
Prof. Ass.Dr. Vrullim Buja

Prishtinë, 2025

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Me anë të kësaj deklarate, unë Krenare Lutfiu, deklaroj që punimi është origjinal dhe është kryer personalisht nga unë, punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo në punime të tjera, punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si personale; punimi i respekton të drejtat e autorit, duke saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burime të tjera.

---

Prishtinë, më: 27.01.2025  
Krenare Lutfiu

## **FALËNDERIM**

Fillimisht do të doja të falënderoja mentorin tim Prof.Ass. Dr. Vrullim Buja për udhëzimet, mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme gjatë punimit të temës së diplomës. E vlerësoj gjithë kohën dhe mundin që ai i ka dedikuar punimit të këtij projekti dhe gjithashtu kontributin për gjetjen e literaturës relevante.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për familjen time e cila më ka përkrahur në çdo aspekt gjatë studimeve universitare. Përpjekjet tuaja dhe besimi në punën time kanë qenë një burim motivimi i jashtëzakonshëm dhe u jam vërtet mirënjohës për kontributin tuaj.

Do të doja të falënderoja edhe të gjithë profesorët të cilët më kanë përcjellë gjatë këtyre viteve të studimit për përkushtimin dhe ndikimin e tyre në rritjen time profesionale dhe akademike.

## Përmbajtja

Kapitulli I- HYRJE.....	1
1.1. Qëllimi i punimit .....	3
1.2. Objektivat e punimit .....	4
1.3. Pyetjet kërkimore.....	4
1.4. Hipotezat e studimit.....	4
1.5. Metoda e studimit .....	5
KAPITULLI II. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1. Nocioni lidërsnip .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.2. Kompetencat e lidërsnipit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.3. Leadership për zhvillimin e qëndrueshëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4. Stilet e lidërsnipit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.1. Stili i lidërsnipit transaksional .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.2. Stili i lidërsnipit transformues.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.3. Leadership demokratik .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.4. Leadership Laissez-faire .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.5. Leadership fuqizues.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.6. Leadership direktiv.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.7. Leadership shërbyes .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.4.8. Leadership karizmatik .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
KAPITULLI III-TEORITË E LIDERSHIPIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.1. Teoria e lidërsnipit në administratën publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.2. Teoria e njeriut të madh .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.3. Teoria e tipareve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.4. Teoritë e kontigjencës (Situacionale) .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5. Teoria e stilit dhe sjelljes së udhëheqjes .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.6. Teoria Transaksionale.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.7. Teoria transformuese .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Kapitulli IV- Leadership në administratë publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1. Qëndrueshmëria organizative në administratën publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2. Ndikimi i stileve të lidërsnipit në kulturën organizatore të institucioneve qeveritare .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

4.2.1. Përshtatshmëria e vizionit dhe misionit në institucionet qeveritare.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2.2. Motivimi dhe angazhimi i punonjësve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2.3. Proceset e vendimmarrjes .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2.4. Komunikimi dhe bashkëpunimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Kapitulli V- METODOLOGJIA DHE REZULTATET E STUDIMIT.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1. Metoda e studimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1.1. Populacioni dhe mostra .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1.2. Instrumentet matëse .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1.3. Procedura.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1.4. Analiza e të dhënave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2. REZULTATET E STUDIMIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2.1. Rezultatet lidhur me të dhënat demografike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2.2. Rezultatet lidhur me testimin e hipotezave.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
KAPITULLI VI- DISKUTIMI I REZULTATEVE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
KAPITULLI VII- PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.1. Përfundimet.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2. Rekomandimet.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
REFERENCAT.....	6
SHTOJCA.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e tabelave

Tabela 1. Besueshmëria e instrumentit matës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 2. Gjinia e responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 3. Moshë e responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 4. Vendbanimi i responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 5. Pozita aktuale e responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 6. Eksperienca në punë e responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 7. Niveli i arsimit të responentëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 8. Modeli për ndikimin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 9. Analiza ANOVA për ndikimin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 10. Koeficientët për ndikimin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 11. Anaiza deskriptive për dallimet gjinore në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 12. Analiza e t-testit për dallimet gjinore në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 13. Anaiza deskriptive për dallimet në moshë në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 14. Anaiza ANOVA për dallimet në moshë në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 15. Anaiza deskriptive për dallimet në vendbanim në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 16. Anaiza e t-testit për dallimet në vendbanim në kontekst të ndikimit të stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 17. Modeli për ndikimin e eksperiencës së punës dhe nivelit të arsimit të lidërëve për të duke përmirësuar aftësitë e udhëheqjes dhe performancën e organizatës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 18. Analiza ANOVA për ndikimin e eksperiencës së punës dhe nivelit të arsimit të lidërëve për të duke përmirësuar aftësitë e udhëheqjes dhe performancën e organizatës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 19. Koeficientët për ndikimin e eksperiencës së punës dhe nivelit të arsimit të lidërëve për të duke përmirësuar aftësitë e udhëheqjes dhe performancën e organizatës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## **ABSTRAKTI**

Ky studim shqyrton rolin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike, duke përdorur komunën e Gjilanit si rast studimi. Qëllimi i studimit është të analizojë si stilet e lidërshiptit ndikojnë në efektivitetin dhe performancën e administratës publike në nivel lokal.

Ky studim përdor një qasje kuantitative duke mbledhur të dhëna nga liderët dhe punonjësit e administratës publike të komunës së Gjilanit përmes anketave. Studimi ka përfshirë një mostër prej 100 respondentëve dhe një pyetësor të strukturuar nga ku kemi nxjerrur të dhënat primare lidhur me rolin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike

Rezultatet e studimit tregojnë se lidërshipti transformues ka një ndikim pozitiv dhe të dukshëm në motivimin dhe angazhimin e punonjësve në administratën publike të komunës së Gjilanit. Kjo formë e lidërshiptit kontribuon në krijimin e një mjedisi të punës më produktiv dhe bashkëpunues, duke rritur eficiencën dhe angazhimin e stafit. Nga ana tjetër, lidërshipti autoritar është i lidhur me një atmosferë pune më pak fleksibël dhe shpesh çon në një komunikim të kufizuar dhe pakënaqësi në mesin e punonjësve. Studimi gjithashtu tregon se lidërshipti i mirëfilltë është i lidhur ngushtë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe aftësinë për të menaxhuar ndryshimet organizative, duke sugjeruar se përmirësimi i stilit të lidërshiptit mund të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e shërbimeve dhe performancës në administratën publike.

Rezultatet e këtij studimi na shërbejnë për të kuptuar ndikimin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike dhe ofrojnë sugjerime për përmirësimin e performancës dhe motivimit të punonjësve në komunën e Gjilanit.

***Fjalët kyqe:*** Lidërshipt, administrata publike, motivim, performancë, Gjilan.

## **ABSTRACT**

This study examines the role of leadership styles in the management of Public Administration, using the municipality of Gjilan as a case study. The purpose of the study is to analyze how leadership styles affect the effectiveness and performance of Public Administration at the local level. This study uses a quantitative approach by collecting data from leaders and employees of the public administration of the municipality of Gjilan through surveys. The study included a sample of 100 respondents and a structured questionnaire from which we extracted primary data on the role of leadership styles in public administration management. The results of the study show that transformational leadership has a positive and visible impact on the motivation and engagement of employees in the public administration of the municipality of Gjilan. This form of leadership contributes to creating a more productive and collaborative working environment, increasing staff efficiency and engagement. On the other hand, authoritarian leadership is associated with a less flexible working atmosphere and often leads to limited communication and dissatisfaction among employees. The study also shows that genuine leadership is closely related to human resource management and the ability to manage organizational change, suggesting that improving leadership style can positively impact on improving services and performance in public administration. The results of this study serve us to understand the impact of leadership styles on Public Administration Management and provide suggestions for improving the performance and motivation of employees in the municipality of Gjilan.

***Key words:*** Leadership, Public Administration, motivation, performance, Gjilan.

## **Kapitulli I - HYRJE**

Lidershipi është një element kyç për funksionimin dhe përmirësimin e organizatave, përfshirë edhe administratën publike (Jumbe & Amos, 2024). Ndërsa organizatat private shpesh ndjekin modele lidershipi të orientuara drejt rezultateve dhe tregut, administrata publike operon në një kontekst të veçantë ku lidershipi efektiv ka ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve publike, mbështetjen e politikave shtetërore dhe përmirësimin e proceseve administrative. Në këtë sektor, lidershipi jo vetëm që përcakton efikasitetin operacional të institucioneve publike, por gjithashtu formëson kulturën organizative, motivimin e punonjësve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët (Keleş, 2022).

Llojet e ndryshme të lidershipit, si lidershipi autoritarian, lejues dhe bashkëpunues, kanë ndikime të ndryshme në mënyrën se si funksionojnë administratat publike. Lidershipi autoritarian është një stil drejtimi ku lideri merr vendime pa konsultuar grupin, duke ushtruar kontroll të fortë mbi vartësit dhe duke përcaktuar detyrat e tyre. Ky stil mund të jetë efektiv në situata që kërkojnë përgjigje të shpejtë dhe drejtim të qartë, por mund të kufizojë pjesëmarrjen dhe kreativitetin e vartësve (Mohammed et al., 2023).

Nga ana tjetër, lidershipi lejues, i njohur edhe si "laissez-faire," karakterizohet nga ndërhyrje minimale të liderit në aktivitetet e grupit, duke u dhënë anëtarëve të tij liri të madhe për të marrë vendime të pavarura. Kjo qasje mund të inkurajojë zhvillimin e autonomisë të vartësit, por mund të çojë në mungesë qartësie dhe disipline nëse grupi nuk është i motivuar ose ka nevojë për udhëheqje të qartë (Alaboody et al., 2024).

Lidershipi bashkëpunues thekson përfshirjen aktive të anëtarëve të ekipit në procesin e vendimmarrjes, duke krijuar një ambient ku çdo zë dëgjohet dhe respektohet. Ky stil promovon komunikimin e hapur dhe shkëmbimin e ideve, duke rritur përkatësinë dhe angazhimin e grupit (Agbodzakey, 2024).

Administrata publike është sistemi i organizimit dhe menaxhimit të institucioneve shtetërore që zbatojnë politikat qeveritare dhe sigurojnë funksionimin e shtetit. Ajo përfshin organizata dhe agjenci që veprojnë në emër të qeverisë për të ofruar shërbime publike dhe për të zbatuar ligjet dhe

rregullat që rregullojnë jetën publike. Administrata publike bazohet në parimet e efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe promovimin e interesit publik (Fialho, 2023).

Në administratën publike, sfidat janë të shumta dhe të ndërlikuara. Menaxhimi i burimeve njerëzore, respektimi i rregulloreve ligjore dhe përballimi i presioneve politike kërkojnë një qasje të qëndrueshme dhe fleksibile ndaj lidërsipit. Në këtë kontekst, stilet e ndryshme të lidërsipit—transformacional, transaksional dhe laissez-faire—kanë një ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si udhëheqësit e administratës publike menaxhojnë sfidat dhe përmbushin detyrat e tyre (Hailu & Verrier, 2024).

Për të kuptuar më mirë ndikimin e stileve të lidërsipit në menaxhimin e administratës publike, një numër studimesh kanë analizuar sesi mënyra e drejtimit ndikon në efektivitetin dhe funksionimin e institucioneve publike.

Një studim i rëndësishëm në këtë fushë është ai Tanović & Šašić, (2023), i cili shqyrton lidërsipin transformacional dhe ndikimin e tij në administratën publike. Kjo hulumtim tregon se liderët transformacionalë, që inspirojnë dhe motivojnë vartësit për të arritur qëllime më të larta, kanë një ndikim pozitiv në përmirësimin e performancës së institucioneve publike. Këta liderë kontribuojnë në rritjen e angazhimit dhe kënaqësisë së punonjësve, duke përmirësuar kështu cilësinë e shërbimeve dhe efektivitetin e organizatës.

Studimi i Liakh (2022) gjithashtu shqyrton rëndësinë e stilit të lidërsipit në administratën publike, duke argumentuar se ai kërkon një fokus të veçantë në etikë, transparencë dhe përgjegjshmëri publike. Ai sugjeron se lidërsipi transformacional dhe ai bashkëpunues janë më të përshtatshëm për menaxhimin e sektorit publik, duke përmirësuar marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të institucioneve.

Një tjetër studim i rëndësishëm është ai i Trotter, Suryadi et al. (2024), i cili tregon se lidërsipi transformacional dhe bashkëpunues kanë një ndikim të rëndësishëm në performancën organizative në kontekstin e administratës publike në Shtetet e Bashkuara. Ky hulumtim tregon se liderët që inkurajojnë pjesëmarrjen e vartësve dhe krijojnë një mjedis bashkëpunimi arrijnë të përmirësojnë jo vetëm performancën e ekipit, por edhe perceptimin e publikut për cilësinë e shërbimeve publike.

Këto hulumtime tregojnë se liderët që inspirojnë dhe motivojnë vartësit, si dhe ata që promovojnë një mjedis bashkëpunues, janë të aftë të rrisin angazhimin dhe kënaqësinë e punonjësve, duke përmirësuar kështu cilësinë e shërbimeve publike dhe performancën organizative. Kjo tregon se stilet e lidërshiptit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe funksionimin e institucioneve publike, duke e bërë të domosdoshme që hulumtimi të përqendrohet në identifikimin e praktikave më të mira të lidërshiptit në këtë kontekst.

Arsyeja dhe motivimi për të studiuar temën "Roli i stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike: Rast studimi komuna e Gjilanit" buron pikërisht nga rëndësia e këtyre studimeve, duke u përpjekur të kuptojmë se si stilet e ndryshme të drejtimit ndikojnë në efektivitetin e administratës publike në nivel lokal.

Ky studim synon të hedhë dritë mbi rolin e stileve të lidërshiptit si autoritar, bashkëpunues dhe lejues në menaxhimin e komunës së Gjilanit. Do të analizohet se si secili prej këtyre stileve ndikon në efikasitetin e punës, kulturën organizative dhe kënaqësinë e punonjësve brenda strukturave publike. Nëpërmjet këtij hulumtimi, do të jetë e mundur të identifikohen praktikatat më të mira që mund të përmirësojnë performancën administrative dhe të nxiten inovacionet në sektorin publik, duke kontribuar kështu në një menaxhim më efektiv dhe transparent.

## **1.1. Qëllimi i punimit**

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të analizojmë Roli i stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike, po ashtu qëllim tjetër i këtij studimi është të shohim dallimet në të dhënat demografike (gjinia, moshë, eksperiencë e punës) në kontekst të stileve të lidërshiptit.

## **1.2. Objektivat e punimit**

Objektivat kryesore të punimit janë:

1. Të analizojmë rolin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike.
2. T'i identifikojmë dallimet në të dhënat demografike (gjinia, mosha, vendbanimi) në kontekst të stileve të lidërshiptit.
3. Të analizojmë ndikimin eksperiencës në punë, nivelit të arsimit të liderëve në menaxhimin e administratës publike.

## **1.3. Pyetjet kërkimore**

Pyetjet kryesore për realizimin e këtij punimi janë:

P1. Si ndikojnë stilet e lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike?

P2. Çfarë dallimesh ekzistojnë në të dhënat demografike (gjinia, mosha, vendbanimi) në kontekstin e stileve të lidërshiptit në administratën publike?

P3. Si ndikon eksperiencia në punë dhe niveli i arsimit të liderëve në menaxhimin e administratës publike?

## **1.4. Hipotezat e studimit**

Hipotezat për realizimin e këtij punimi janë:

H1. Stilet e lidërshiptit kanë një ndikim të rëndësishëm në menaxhimin e administratës publike, duke ndikuar në efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike.

H2. Ekzistojnë dallime të dukshme në të dhënat demografike (gjinia, mosha, vendbanimi) që ndikojnë në stilin e lidërshiptit të përdorur në administratën publike.

H3. Eksperiencia në punë dhe niveli i arsimit të liderëve ndikojnë pozitivisht në menaxhimin e administratës publike, duke përmirësuar aftësitë e udhëheqjes dhe performancën e organizatës.

## **1.5. Metoda e studimit**

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e studimit, është përdorur metoda kuantitative (sasiore) e studimit. Metodatat sasiore theksojnë matjet objektive dhe analizën statistikore, matematikore ose numerike të të dhënave që mblidhen përmes sondazheve, pyetësorëve dhe anketave, ose duke manipuluar të dhënat statistikore para-ekzistuese duke përdorur teknika llogaritëse. Kjo metodë na ka ndihmuar të analizojmë në mënyrë sasiore rolin e stileve të lidërshiptit në menaxhimin e administratës publike.

## REFERENCAT

- Abawari, A. M., Debela, K. L., & Abegaz, M. B. (2024). The effects of organizational culture on change management in Oromia public sectors: the mediating role of leadership styles. *Cogent Business & Management*, 11(1). <https://doi.org/10.1080/23311975.2024.2375623>
- Abdulhakeem, U. S., Hamza, M. A., & Suleman, G. D. (2022). Impact of principals' leadership styles on truancy among students of public secondary schools in Zamfara State Metropolis, Nigeria. *Kashere Journal of Education*, 2(2), 165–170. <https://doi.org/10.4314/kje.v2i2.23>
- Abenoja, J. B., Blase, D. J. C., & Almagro, R. E. (2024). Organizational Culture and Leadership Style Among Local Government Unit of Davao del Norte, Philippines. *Tarbawi Jurnal Keilmuan Manajemen Pendidikan*, 10(02), 169–184. <https://doi.org/10.32678/tarbawi.v10i02.10449>
- Agbodzakey, J. (2024). Leadership in collaborative governance. In *SpringerBriefs in political science* (pp. 15–25). [https://doi.org/10.1007/978-3-031-57373-6\\_2](https://doi.org/10.1007/978-3-031-57373-6_2)
- Alaboody, A. a. a. R., Shukri, D. I. A., & Albander, M. H. (2024). Analysis of leadership styles of Blake and Mouton: A comparative study of leadership interactions in different environments. *Integrated Journal for Research in Arts and Humanities*, 4(3), 18–23. <https://doi.org/10.55544/ijrah.4.3.4>
- Al-Omari, A. A. (2013). The Relationship between Decision Making Styles and Leadership Styles among Public School Principals. *International Education Studies*, 6(7). <https://doi.org/10.5539/ies.v6n7p100>
- Awaru, A. O. T. (2024). Social dynamics in Public Administration: A case study of Local government. *Jurnal Ilmiah Ilmu Administrasi Publik*, 14(1), 73. <https://doi.org/10.26858/jiap.v14i1.62755>
- Buja, V., Qerimi, F., & Behluli, A. (2022). The impact of leadership styles on service quality and citizen satisfaction in Kosovo's public sector. *Innovative Marketing*.
- Burns, J. M. (2012). *Leadership*. Open Road Media.
- Čajková, A., & Igljar, R. (2024). Kitsch in Decision-making: Leadership in Public Administration. In . (pp. 169–186). [https://doi.org/10.1007/978-3-031-72237-0\\_9](https://doi.org/10.1007/978-3-031-72237-0_9)

- Dogan, B., & Yıldız, B. (2023). The Correlation between Leadership Styles and Organizational Cynicism: Which Leadership Style is Best for Schools? *International Journal of Education and Literacy Studies*, 11(4), 343–352. <https://doi.org/10.7575/aiac.ijels.v.11n.4p.343>
- Donkor, F. (2021). Linking leadership styles to employee performance in the public sector organizations in Ghana: The role of organizational commitment. *International Journal of Business and Management*, 16(5), 43. <https://doi.org/10.5539/ijbm.v16n5p43>
- Fattah, O. A., Zureigat, A., & Elayyan, A. (2018). The relationship between the leadership styles and the organizational climate in public schools in Amman. *Asian Social Science*, 14(12), 97. <https://doi.org/10.5539/ass.v14n12p97>
- Fialho, E. (2023). Public administration leadership and public policies. *Deleted Journal*, 19(1), 136–146. <https://doi.org/10.34190/ecmlg.19.1.1937>
- Ghafory, H., & Sahnosh, F. A. (2024). The Role of Leadership Styles in Project Management: Systematic Literature review. *Jurnal EMT KITA*, 8(4), 1579–1585. <https://doi.org/10.35870/emt.v8i4.3284>
- Gregoriou, I., Economidou, E. C., Avraam, D., Soteriades, E. S., Papastavrou, E., Charalambous, A., Stylianides, A., & Merkourios, A. (2024). Leadership and Job satisfaction among Physicians in the Public Health Sector of Cyprus. *Research Square (Research Square)*. <https://doi.org/10.21203/rs.3.rs-4293854/v1>
- Hailu, R. B., & Verrier, D. (2024). Study Gaps in leadership Styles and Employees Performance in Public Sectors: A Review of literature. *International Journal of Human Resource Studies*, 14(2), 76. <https://doi.org/10.5296/ijhrs.v14i2.21819>
- Hanania, H., Al-Jamal, S., & Jaradat, N. (2024). The relationship between modern leadership styles and the development of middle management leaderships. *Ahliya Journal of Business Technology and MEAN Economies.*, 1(2), 81–102. <https://doi.org/10.59994/ajbtme.2024.2.81>
- Ibraimi, X., Ziberi, B., & Hoxha, A. (2023). The importance of the regulation of the public sector for sustainable development. *Corporate Law and Governance Review*.
- Jekelle, H. E. (2021). Leadership Styles Dimensions and Organizational Commitment Nexus: Evidence from a Public Sector in Nigeria. . <https://doi.org/10.31219/osf.io/djkqz>
- Jumbe, R., & Amos, O. (2024). Significance of educational leadership styles on pupils academic achievement in primary public schools in Morogoro Municipality, Tanzania.

- International Journal of Innovative Science and Research Technology (IJISRT)*, 2664–2668. <https://doi.org/10.38124/ijisrt/ijisrt24sep167>
- Keleş, N. (2022). Leadership, leadership styles and leadership in Public Administration Special of Turkish Customs Administrations. *Uluslararası Liderlik Çalışmaları Dergisi Kuram Ve Uygulama*, 5(2), 72–85. <https://doi.org/10.52848/ijls.1070904>
- Kindarto, A., Zhu, Y., & Gardner, D. G. (2020). Full range leadership styles and Government IT team performance: the critical roles of follower and team competence. *Public Performance & Management Review*, 43(4), 889–917. <https://doi.org/10.1080/15309576.2020.1730198>
- Lasso, F. a. G., Gallego, F. L., & Marquina, P. (2021). Ethics position and leadership style in a mayor's office. *International Journal of Psychological Research*, 14(2), 82–92. <https://doi.org/10.21500/20112084.5573>
- Liakh, Y. (2022). Leadership in Public Administration: Prospects for development in Ukraine. *University Scientific Notes*, 106–115. <https://doi.org/10.37491/unz.87.8>
- Litsulitsa, A. H., Kungu, P., & Kiiru, D. (2024). The Mediating Influence of Leadership Style within the Nexus of Organizational Agility and Performance Outcomes in Public Universities in Kenya. *International Journal of Research and Innovation in Social Science*, VIII(VIII), 331–357. <https://doi.org/10.47772/ijriss.2024.808028>
- Masenya, J., & Ngoepe, M. (2024). Quitting leadership style? The influence of transformational and transactional leadership styles on librarians' retention in municipal libraries. *Library Management*. <https://doi.org/10.1108/lm-09-2024-0095>
- Mohammed, H. B., Abdulla, A. a. M., Albert, F. I., Mohamad, I. M. R., & Geraldine, D. M. (2023). The impact of leadership styles among UAE municipalities employees. *GLOBAL BUSINESS & FINANCE REVIEW*, 28(4), 115–131. <https://doi.org/10.17549/gbfr.2023.28.4.115>
- Moon, K., & Park, J. (2019). Leadership styles and turnover behavior in the US Federal Government: Does span of control matter? *International Public Management Journal*, 22(3), 417–443. <https://doi.org/10.1080/10967494.2018.1557767>
- Nordin, R., & Nasir, H. M. (2017). Leadership Styles and Gender Relationship among Public Higher Institutions in Malaysia. *ADVANCES IN BUSINESS RESEARCH INTERNATIONAL JOURNAL*, 3(1), 58. <https://doi.org/10.24191/abrij.v3i1.10038>

- Profiroiu, A. G., & Nastacă, C. C. (2022). Impact of leadership and gender on civil servants' resilience in the Romanian state's public administration. *Transylvanian Review of Administrative Sciences*, 67 E, 63–80. <https://doi.org/10.24193/tras.67e.4>
- Rasheed, R., Rashid, A., & Ngah, A. H. (2024). Role of leadership styles to foster innovative capabilities and green purchasing. *Journal of Global Operations and Strategic Sourcing*. <https://doi.org/10.1108/jgoss-05-2023-0047>
- Sabharwal, M., Levine, H., & D'Agostino, M. J. (2017). Gender differences in the leadership styles of MPA directors. *Journal of Public Affairs Education*, 23(3), 869–884. <https://doi.org/10.1080/15236803.2017.12002293>
- Sakiru, O. K., Othman, J., Silong, A. D., Kareem, S. D., Oluwafemi, A. O., & Yusuf, G. O. (2014). Relationship between Head of Department Leadership Styles and Lecturers Job Satisfactions in Nigerian Public Universities. *Asian Social Science*, 10(6). <https://doi.org/10.5539/ass.v10n6p138>
- Salem, H. (2019). The Practiced Leadership Styles and their Relation to Administrative Communication Styles among Public School Principals in Jerash Governorate. *An-Najah University Journal for Research - B (Humanities)*, 33(2), 305–349. <https://doi.org/10.35552/0247-033-002-006>
- Seçilmiş, C., Sarı, Y., & Kılıçlar, A. (2016). Kamu yönetiminde mülki idare amirlerinin sergiledikleri liderlik tarzlarının değerlendirilmesine yönelik bir araştırma (The Research for the Assessment of Leadership Styles of Public Authorities in Public Administration). *Journal of Business Research - Turk*, 8(1), 117. <https://doi.org/10.20491/isader.2016.137>
- Suryadi, Y., Dewi, N. L. Y., Trisnawati, T., & Al-Amin, A. (2024). The impact of transformational leadership on organizational performance and employee motivation. *Transforma Jurnal Manajemen*, 2(2), 65–76. <https://doi.org/10.56457/tjm.v2i2.129>
- Tanović, M., & Šašić, Đ. (2023). Transformational leadership as a prerequisite for organizational development in public administration. *Uprava*, 14(1), 37–52. <https://doi.org/10.53028/1986-6127.2023.14.1.37>
- Terziu, L., & Belegaj, B. (2023). Understanding voter behavior and election dynamics in post-war Kosovo. *Journal of Liberty and International Affairs*.

- Terziu, L., & Buleshkaj, O. (2023). Challenges in leading educational change: Reflections from Kosovo's higher education system. *The International Journal of Educational Organization and Leadership*.
- Thanh, N. H., Van Quang, N., & Anh, N. N. (2022). The relationship between leadership style and staff work engagement: An empirical analysis of the public sector in Vietnam. *Humanities and Social Sciences Communications*, 9(1). <https://doi.org/10.1057/s41599-022-01354-7>
- Turyahikayo, W., Mugizi, W., & Kasule, G. W. (2024). Leadership styles and organisational communication in selected public universities in Uganda. *Interdisciplinary Journal of Management Sciences.*, 1, 1–13. <https://doi.org/10.38140/ijms-2024.vol1.03>
- Tzavella, V. (2023). The leader – manager debate in the Greek public administration: a critical review of the literature and future research agenda. *International Conference on Business and Economics - Hellenic Open University*, 2(1). <https://doi.org/10.12681/icbe-hou.5357>
- Ubogu, R. (2018). Analysis of leadership styles on school administration in public secondary schools in Delta Cental Senatorial Districts, Delta State, Nigerian. *World Journal of Educational Research*, 5(1), 77. <https://doi.org/10.22158/wjer.v5n1p77>
- Vasilios, V., & Xanthopoulou, P. I. (2024). Types of leadership and their impact on the effectiveness and efficiency of the public organizations: a literature review. *Research Gate*, 28–30. <https://doi.org/10.22495/cgrapp4>